



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM Nr. 19 datë 09.03.2011

**PËR MIRATIMIN E TREGUESVE TË PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT
EKONOMIK PËR VITIN 2011 TË SH.A “UJËSJELLËS KANALIZIME“
KORÇË**

Këshilli Bashkiak në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe të Udhëzimit Nr. 965, datë 11.12.2007 Për zbatimin e VKM “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës – kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore” pika V/7, pasi u njoh me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Nr. 5 mb 10/04, datë 24.12.2010 dhe pasi shqyrtoi relacionin e programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2011 dërguar me shkresë nga Drejtoria e Sh.A UKKO.

VENDOSI

1. Të miratojë treguesit kryesorë të programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2011 të Sh.A “Ujësjetllës Kanalizime“ Korçë si vijon:

1. Të ardhurat nga aktiviteti	260.640.000 lekë
2. Shpenzimet gjithsej	258.020.000 lekë
3. Numri mesatar i punonjësve	90
4. Fondi i pagave	60.000.000 lekë

Të punohet me efektivitet në drejtim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet, arkëtimit të plotë të vlerës të ujit të faturuar si dhe për mirëadministrimin e shpenzimeve.

2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

GJERGJI PENDAVINJI